

eppc kërkon një *Menaxher Blerjesh (për produkte elektronike)*, për klientin e saj, i cili është një ndër kompanitë më të mëdha në fushën e shitjeve në vend.

NJË VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM:

Kompania është në kërkim të një kandidati i cili duhet të kryej blerje të produkteve elektronike nga furnitorë të huaj ose të brendshëm me qëllim rishitjen e tyre. Kandidati duhet të ketë aftësi shumë të mira shitjeje dhe negociimi, si edhe aftësi të shkëlqyera analitike për të përshtatur blerjet me atë çfarë kërkon tregu.

Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Diplomë Universitare;
- Përvojë e mëparshme në sektorin e blerjeve;
- Të zotëroj shkëlqyeshëm gjuhën Angleze (*domosdoshmëri*);
- Të zotërojë shumë mirë paketën MS Office;
- Te jetë person i besueshëm dhe i gatshëm të marr përsipër përgjegjësi;
- Të jetë i aftë të punoj nën presion, të ketë iniciativë dhe të jetë bashkëpunues.

Përgjegjësitë Kryesore:

- Identifikimi i nevojave të kompanisë për furnizimin e produkteve apo kategori produktesh;
- Ndërtimi i marrëdhënieve të komunikimit me partnerët e biznesit brenda dhe jashtë vendit;
- Negocimi për blerjen e produkteve;
- Përditësimi i të dhënave për furnitorët, artikujt dhe çmimet;
- Analiza e furnitorëve për të njëjtin produkt apo kategori produktesh;
- Dhënia e porosive dhe ndjekja e tyre në procesin e zbatimit;
- Koordinimi i punës me Departamentin e Shitjeve.

Të dhënat:

Pozicioni:	Menaxher i Blerjeve;
Vendndodhja:	Autostradë;
Orari:	40 orë në javë;
Udhëtime pune:	Po;
Pagesa:	Shumë e mirë;
Kontrata:	Sipas Kodit të Punës;
Aplikimet mbyllen:	8 Mars 2014.

Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj dhe dokumentet e tjera shoqëruese duke **përmendur pozicionin për të cilin aplikoni** në adresën e e-mail-it:

recruitments@eppc.al

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj dhe dokumentet shoqëruese do të kualifikohen. Tek ne CV-ja juaj është e sigurt dhe trajtohet në konfidencialitet të plotë.